



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Изборни Панел за Жалбе и Представке

Anr.131/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë komuna Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 30.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa e organizatës Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Komuna Prizren, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2.200,00 (dymijë e dyqinë euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 29.09.2019, me të cilën pretendon se në komunën e Prizrenit, në lagjën Ortakoll në rrugën “Hamit Bojniku“ monitoruesi ynë ka hasur në disa posterë të kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në dy trafostacione të energjisë elektrike të kësaj lagjeje. Paraqitësi i ankesës thekson se me këto veprime subjekti politik LDK ka shkelur nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesi ka bashkangjitur disa fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

PZAP-i me datën 29.09.2019 e njoftoi subjektin politik LDK me ankesën e parashtruar dhe kërkoi nga e njëjta që deri me datën 30.09.2019 të përgjigjet në ankesë. Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 30.09.2019, kanë theksuar se në kushtet dhe rrethanat të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore dhe duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur ashtu siq kërkohet në dispozitat ligjore, të krijojnë hapsira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore dhe sipas tyre vendosja e posterave në një trafostacion elektrike nuk duhet të trajtohet si shkelje. Subjekti politik në përgjigjen e tij pretendon se në trafostacionin elektrike, pavarësisht faktit që është pronë publike tek ne në Kosovë janë përdorur në mungesë të hapsirave të dedikuara për këtë. Pavarësisht kësaj subjekti politik LDK njofton se ka ndërmarr masat e duhura dhe ka evituar shkeljen e pretenduar nga kandidati në fjalë, duke larguar foto e kandidatit për deputet, dhe menjëherë pas pranimit të ankesës i kemi ndërmarr veprimet përmirësuese, pra nga këto veprime është evituar shkelja sipas pretendimeve në ankesë.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur tri fotografi nga vendi ku janë larguar posteret e kandidatit nga Lidhja Demokratike e Kosovës, lidhur me rastin në fjalë.

Mungesa e hapësirave adekuate për vendosjen e posterave nuk mund të shfrytëzohet si arsyetim për shkeljen e ligjit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik i ka vendosur posteret , në trafo stacione elektrike, veprim ky që është në kundërshtim 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t’u përgjigjur, por e njëjta ka ofruar përgjigje dhe kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vlerësoj se kjo do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 131/2019 më datën 02.10.2019**

**Kryesuesi i Panelit**  
**Adnan Konushevc**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.